

Zotimi i parë: është vlerësuar si i përmbushur në qoftë se janë publikuar të gjitha vendimet e Kryetarit dhe të Kuvendit Komunal (në një kohë arsyeshme nga marrja e vendimit deri në publikim), si dhe janë publikuar dhe janë të qasshme rregulloret dhe planet urbanistike.

Zotimi i dytë: është vlerësuar si i përmbushur përderisa komuna i ka publikuar raportet e shpenzimeve dhe rezultatet e konkurseve.

Zotimi i tretë: është vlerësuar si “i përmbushur” nëse janë mbajtur konsultime të rregullta me banorë në lagje dhe fshatra, përfshi takimet publike në të dy gjashtë mujorët, dëgjime buxhetore dhe konsultime të tjera për çështje të ndryshme siç janë rregulloret, hartat zonale, etj. në lagje por edhe në fshatra të komunës.

Zotimi i katërt: komunat që kanë mbajtur konsultime publike për draftim të planeve të prokurimit, i ka bërë publike të gjitha kontratat e vitit 2018 dhe e ka publikuar planin e prokurimit në fillim të vitit (muajt e parë) janë vlerësuar se e kanë përmbushur “plotësisht” zotimin.

Zotimi i pestë: komunat që nuk e kanë publikuar raportin vjetor të progresit për realizimin e premtimeve zgjedhore në vitin e parë të këtij mandati qeverisës deri në fund të janarit 2018, janë vlerësuar se nuk e kanë përmbushur këtë zotim.

Zotimi i gjashtë: edhe pse niveli i adresimit të ankesave të qytetarëve që kanë ardhur përmes platformës ndreqe.com mund të jetë mjet mjaft objektiv për matjen e përmbushjes së zotimit, në këtë rast në vlerësim kanë hyrë edhe elemente si: numri total i raportimeve, numri total i rregullimeve, si dhe numri mesatar i ditëve nga raportimi deri në rregullim.